



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **56**

Prishtinë, më 27.10.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Dragiša Mirić, Ali Lajçi, Elheme Hetemi, Zulfi Merxha.

Munguan : Zef Morina, Lulzim Zeneli.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : përfaqësuesit të ministrisë së bujqësisë Njazi Idrizi dhe Shefki Zeqiri, vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshim/plotësimin e ligjit për Pyjet,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Naim Maloku konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet

Naim Maloku falënderoi kryesuesin e GP Berat Luzhën për njoftime dhe punën që bëhet në grupin punues rreth pyjeve, ndërkaq **Berat Luzha** shtoi se grupi ndoshta ka mundur më tepër të kontribuoi por puna jokomplete e grupit (Zef Morina ka marr pjesë vetëm një herë në takime) ka ndikuar për gjendjen ashtu si është, megjithatë angazhimet me ministrin Vehapi dhe pjesëmarrja në një tryezë në Pejë kanë ndikuar që grupi punues të sugjeroj dy amendamente komisionit (të propozuara nga MBPZHR) me kusht që shumë shpejt ministria të filloi të draftoj një ligj të ri për Pyje. Ai gjithashtu njoftoi komisionin se OJQ “Syri Vizion” është i gatshëm të mbështet një tryezë pune në Prishtinë (reagoi përfaqësuesi dhe tha

se për Pejë është fjala) me akterët kryesorë sa i përket pyjeve, ndaj i propozoi komisionit të marr qëndrim për këtë takim që propozohet të mbahet më 2.11.2009.

Naim Maloku mbështeti dy amendamentet e sugjeruara të cilat do të miratoi komisioni në mbledhjen e radhës por nuk mbështeti propozimin për mbajtjen e tryezës ngase pak shpresa ka që mund të dëgjohen ndryshime kualitative. Dy propozimet e ministrisë përfshijnë shqetësimet aktuale dhe mjaftojnë tani për tani derisa në ndërkohë ministria përgatit ligjin e ri. Tryeza do të mbahet patjetër në Pejë por me rastin e draftimit të ligjit të ri, përfundoi. Sa i përket propozimit për mosmbajtjen e mbledhjeve të komisionit deri 15 nëntor plotësisht u pajtua.

Elheme Hetemi gjithashtu u pajtua se tani për tani janë qartësuar gjërat në masën e duhur dhe nuk ka nevojë për takime (dëgjime) tjera ngase ndryshe nuk bënë, ajo kërkoi që deri më 17 nëntor të gjendet zgjidhja për përqindjen e financave që do të kalojnë komunave. Ajo nuk mbështeti mbajtjen e tryezës së propozuar dhe propozoi që të shtyhet së paku tani kur është vllugu i fushatave zgjedhore.

Berat Luzha rikujtoi se gjatë dëgjimit të parë publik për pyjet komisioni është pajtuar të mbahet edhe një herë debati për shkak të shqetësimeve të shumta nga komunat se si do ti kalojnë kompetencat komunave, ndërsa edhe takimi në Pejë arsyetoi këtë nevojë të mbajtjes së takimit regional.

Naim Maloku pyeti sa anëtarë miratojnë propozimin në fjalë duke arsyetuar kërkesën e tij se nuk ka nevojë për debate tjera momentalisht ngase komunat “më tepër harxhojnë energji për shkaqe buxhetore sesa për probleme reale dhe askush nuk i merr vesh se çka po donë”.

Komisioni nuk kishte nevojë të aplikoi procedurën e votimit ngase anëtarët prezent më tepër miratuan propozimin për mosmbajtje të debatit regional në Pejë.

Selvie Halimi tha se në dëgjimin e mbajtur nuk kemi pasur propozime konkrete nga komunat, ndaj nëse ka vërejtje konkrete nga komunat ende është i hapur komisioni ndërkohë për ato, përndryshe ajo pyeti Berat Luzhën ku qëndron arsyeja për kërkesën e mbajtjes së dëgjimit regional. **Berat Luzha** u përgjigj se duhet hequr dilemat nga kërkuessit. Ajo prapë konstatoi se është humbje kohe.

Njazi Idrizi nga ministria e bujqësisë shprehu disponimin e shumicës së anëtarëve të komisionit që ky projektligj të shkoj në miratim menjëherë ndërsa në ndërkohë ministria premtun që shpejt do të draftojë ligjin e ri, ngase “dispozitat e Ahtisarit” obligojnë institucionet vendore të veprojnë urgjentisht në këtë drejtim, por edhe për shkak të miratimit të Ligjit të pushtetit lokal. Për tryezën e propozuar nuk kishte asgjë kundër por konstatoi se komunat e Kosovës kanë mendime të ndryshme për menaxhimin me pyje, disa kërkojnë kompetenca derisa tjerët kanë mendimet e ndara.

Ali Lajçi përkrahu propozimet e grupit punues ngase janë të kapshme dhe rrjedhin nga propozimet e ministrisë të cilët me gjasë kanë arrit të identifikojnë problemet kyçe në terren dhe i kanë inkorporua gjërat esenciale në kuadër të këtyre dy propozimeve, ndaj ishte i mendimit që ato do të jenë dispozita të mjaftueshme deri në hartimin e ligjit të ri, përndryshe ai mendon se problemi qëndron tek përgjegjësia ndaj obligimeve të cilat mjaft mirë janë precizuar me këto dy amendamente, 20%-shi i komunave propozoi të hyn në raport. Gara për kompetenca në mes ministrisë dhe komunave është pak e rëndësishme nëse ka përgjegjësi të duhur, përfundoi ai.

Heset Cakolli gjithashtu përkrahu që të procedohet projektligji me këto dy amendamente pastaj të hartohet ligji i ri. Sa i përket tryezës së propozuar, nuk ka nevojë të mbahet.

Naim Maloku falënderoi dhe në emër të komisionit nxori këtë :

K O N K L U D I M

Rekomandohet që komisioni në mbledhjen e radhës më 17 nëntor 2009 të miratoi dy amendamentet e propozuara nga grupi punues rreth projektligjit për pyje të cilat në

ndërkohë do të rishikohen nga anëtarët e komisionit në bashkëpunim me zyrtarët e ministrisë së bujqësisë.

Të ndryshme

Berat Luzha kërkoi sqarime rreth shfrytëzimit të fondit financiar të komisionit, sa është ky fond dhe sa janë mundësit për shfrytëzim.

Blerim Vela (OSCE) kërkoi sqarim rreth projektligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta e banesës sepse në Raportin e Progresit për vitin 2009 Komisioni Evropian ka vërejtje serioze për këtë.

Naim Maloku tha se projektligji në fjalë është përfunduar në këtë komision funksional por çka veprohet në komisionin për komunitete nuk jemi në dijeni, ndërsa lidhur me fondin e komisionit mendoi se bëhet fjalë për shumën e mbetur prej 5.000 euro, ndaj në emër të komisionit parashtrroi këto dy kërkesa :

K Ë R K E S Ë

- 1. Për mbledhjen e datës 17 nëntor 2009 të sigurohet informata nga ekstrakti i rregullores në fuqi (apo nga burimi tjetër relevant) sa është fondi i mbetur financiar i këtij komisioni dhe si janë mundësitë për shfrytëzimin e atyre mjeteve.**
- 2. Nga Departamenti Ligjor kërkohet informata për këtë komision se në cilin fazë të shqyrtimit në komisionet kryesore gjendet projektligji për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00. Mbledhja e radhës do të mbahet më 17.11.2009.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku